



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 762/Prot.
6

Tiranë, më 28/6 /2017

VENDIM

Nr. 85, datë 28/6 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Av. _____, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankimin nr. 762 Prot., datë 08.05.2017, kundër Autoritetit Publik “Kontrolli i Lartë i Shtetit” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion si më poshtë:

1. Kopje të kallëzimit penal me nr. 731/4 Prot., datë 18.11.2013;
2. Kopje të kallëzimit penal me nr. 731/10 Prot., datë 31.12.2013;
3. Kopje të kallëzimit penal me nr. 567/9 Prot., datë 21.11.2013;
4. Kopje të kallëzimit penal me nr. 1241/10 Prot., datë 24.05.2013;
5. Kopje të kallëzimit penal me nr. 709/17 Prot., datë 26.12.2013;
6. Kopje të kallëzimit penal me nr. 709/16 Prot., datë 26.12.2013;
7. Kopje të kallëzimit penal me nr. 243/7 Prot., datë 13.05.2013;
8. Kopje të kallëzimit penal me nr. 164/9 Prot., datë 13.05.2013;
9. Kopje të kallëzimit penal me nr. 245/9 Prot., datë 24.07.2013;
10. Kopje të kallëzimit penal me nr. 245/10 Prot., datë 24.07.2013;
11. Kopje të kallëzimit penal me nr. 1103 Prot., datë 31.03.2013;
12. Kopje të kallëzimit penal me nr. 197/10 Prot., datë 30.06.2013;
13. Kopje të kallëzimit penal me nr. 197/11 Prot., datë 30.06.2013;
14. Kopje të kallëzimit penal me nr. 941/42 Prot., datë 30.06.2013;
15. Kopje të kallëzimit penal me nr. 1240/29 Prot., datë 31.05.2013;
16. Kopje të kallëzimit penal me nr. 1240/30 Prot., datë 31.05.2013;
17. Kopje të kallëzimit penal me nr. 1240/31 Prot., datë 31.05.2013;
18. Kopje të kallëzimit penal me nr. 1240/32 Prot., datë 31.05.2013

Autoriteti Publik i është përgjigjur kërkuarit me shkresën nr. 309/4 Prot., datë 07.04.2017 duke refuzuar dhënien e informacionit të kërkuar dhe duke e drejtuar këtë të fundit në Prokuroritë e Rretheve.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 762 Prot., datë 08.05.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, me urdhrin nr. 141 Prot, datë 12.05.2017, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Qendrës “Res Publica” është depozituar pranë Autoritetit Publik dhe është regjistruar me nr. 309/2 Prot., datë 27.03.2017. Nga ana e përfaqësuesve të Autoritetit Publik u kërkuar kohë për përgatitjen e informacionit të nevojshëm, objekt inspektimi.

Me shkresën nr. 532/1 Prot., datë 17.05.2017 Autoriteti Publik arsyeton refuzimin për dhënien e informacionit duke sqaruar se nuk disponon statistika të përditësuara lidhur me ecurinë e çështjeve që janë regjistruar nga ana e Prokurorisë. Në mungesë të informacionit në lidhje me statusin juridik të kallëzimeve penale, bazuar në pikën 2 të nenit 103 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se *ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake*, dhënia këtij dokumentacioni mund të çënoj ecurinë e hetimit. Gjithashtu, Autoriteti Publik e drejton kërkuarin në Prokurori si institucioni i vetëm që çmon dhe disponon një informacion të tillë.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personalekur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Me shkresën nr. 762/4 Prot., datë 24.05.2017, Komisioneri njoftoi palët në një seancë dëgjimore në datën 05.06.2017. Në seancë dëgjimore, pala ankuese dhe përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili përcakton se: *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Gërma dh), e pikës 1, të nenit 7, të ligjit “Për të drejtën e informimit”, përfshin në kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë në Programin e Transparencës edhe raportet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Arsyetimi i Autoritetit Publik se pika 2, e nenit 103 të Kodit të Procedurës Penale, parashikon *ndalimin e publikimit, qoftë edhe të pjesshëm, të akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve*

paraprake, nuk qëndron, pasi kallëzimet penale janë akte administrative si rrjedhojë e shkeljeve të konstatuara në raportet e auditimit, të cilat janë publike.

Për sa më sipër, informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica" është informacion publik, i cili prodhohet dhe administrohet nga autoriteti publik. Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

Vlen të theksohet se, sa i përket informacionit të kërkuar në pikat 4, 11, 15, 16, 17 dhe 18 të kërkesës së datës 23.03.2017, Komisioneri është shprehur edhe më parë me vendimin nr. 88, nr. 90, datë 25.11.2016 dhe vendimin nr. 94, datë 05.12.2016 duke urdhëruar Prokurorinë e Përgjithshme/Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vënien në dispozicion të Qendrës "Res Publica" lidhur me kopjet e kallëzimeve të bëra nga Autoriteti Publik. Gjithashtu, me vendimin nr. 93, datë 30.11.2016, Komisioneri ka urdhëruar Prokurorinë e Përgjithshme/Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier lidhur me informacionin e kërkuar në pikat 2 dhe 7 të kërkesës së Qendrës "Res Publica" drejtuar Autoritetit Publik.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, kufizimet e pasqyruara në legjislacionin e zbatueshëm nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar dhe personat përgjegjës duhet ta vënë atë në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe duke respektuar nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën Qendrës "Res Publica", përfaqësuar nga Z. kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër lidhur me kufizimet në dhënien e informacionit, ankimi duhet pranuar pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëve shjeve administrative',

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës Nr. 762 Prot., datë 08.05.2017, të Qendrës "Res Publica" përfaqësuar nga Z. , ndaj Autoritetit Publik "Kontrolli i Lartë i Shtetit" , me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informim datë 23.03.2017 në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, si dhe duke respektuar nenet 5, 6, 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, brenda datës 06. 7 .2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u dha sot me datë 28. 6 .2017.

